



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 3186 prot.

Shkodër, më 17.10 2023

Lënda : Publikim njoftimi në Buletin e Njoftimeve Publike

Drejtuar : Agjensisë së Prokurimit Publik

pranë


Këshillit të Ministrave

Tiranë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike të rradhës për një vende pune. Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI

Prof.dr. Rajmonda Këcira



Konceptoi G Boriçi, datë 13.10.2023

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, +355(22)800651, <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 3186/ prot.

Shkodër, më 17.10 2023

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Departamenti i Gjeografisë, në pozicionin asistent-lektor/e me kohë të plotë për vitin akademik 2023-2024, për lëndët "Bazat e gjeologjisë", "Gjeologji historike". "Gjeologji ambientale" dhe "Hartografi".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret specifike :

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse (Dega gjeologji), në sistemin me kohë të plotë.
2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 6 (Bachelor, Program studimi i nivelit të parë) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë).
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Master i arteve/Master i arteve të bukura/Program studimi i nivelit të dytë, Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë).
4. Nota mesatare e grupit të lëndëve për të cilat konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë). Kandidati që konkurren duhet ti ketë dhënë domosdoshmërisht provim lëndët për të cilat pretendon të jetë mësimdhënës.
5. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, me notë jo më të ulët se 8 (tetë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose të njohur nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
6. Të kenë së paku pesë vite përvojë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë në disipinën e gjeologjisë.
7. Të kenë botime të punës kërkimore shkencore në fushën e gjeologjisë.
8. Të kenë njohuri mbi Hartografinë dhe Sistemet e Informatizimit Gjeografik (GIS) të njohura me certifikatë/dëshmi që vërtetojnë këto njohuri.
9. Të kenë njohuri kompjuterike dhe informatike bazë.

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
7. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës egzistues brenda të njëjtes njësi bazë/drejtorisë ku kërkojnë të punësohen.

Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresen www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Fotokopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Fotokopje e noterizuar e gradës shkencore "Doktor" në specialitetin e lartpërmendur dhe/ose titujve akademikë (nëse ka të tilla).
5. Tre rekomandime nga të cilat të paktën dy prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbartimit)
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë + certifikatë vaksinimi anti-Covid)
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e sakët, si drejtoheni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

Prof.dr. Rajmunda KEÇIRA

